Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosova Council for the Cultural Heritage

27.07.2026

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 4, paragrafit 8 të Ligjit Nr.02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe me qëllim të funksionimit dhe përmbushjes së detyrave të tij profesionale, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, miraton këtë:

# RREGULLORE NR. 01/2026 PËR PUNËN E KËSHILLIT TË KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE

## KREU 1

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Kjo rregullore përcakton dispozitat përkatëse të rregullimit të punës së agjencisë së pavarur, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (në tekstin e mëtejmë: KKTK), duke përfshirë vendosjen e rregullave për funksionet institucionale dhe administrative.

### Neni 2

### FUSHËVEPRIMI

1. Dispozitat e kësaj Rregullore, janë të detyrueshme për Organin Drejtues Kolegjial dhe të gjithë zyrtarët publikë të punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

2. Funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e KKTK-së janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore si dhe Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

## Neni 3
## PËRKUFIZIMET

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:

1.1. "KKTK" nënkupton Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

1.2. "Organi Drejtues Kolegjial" (ODK) nënkupton organin udhëheqës të KKTK, që përbëhet nga shtatë (7) anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

1.3. "Kryetari" nënkupton udhëheqësin e Organit Drejtues Kolegjial.

1.4. "Sekretariati" nënkupton nëpunësit civilë në KKTK.

1.5. "Drejtori i Përgjithshëm" nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KKTK-së.

1.6. "Divizionet" nënkupton strukturën themelore të organizimit në kuadër të KKTK-së

1.7. "Komisione të pavarura" nënkupton komisione të pavarura që krijohen nga Organi Drejtues Kolegjial i KKTK-së, për çështje të ndryshme të përcaktuara me Ligj dhe Rregullore.

# KREU 2

# DISPOZITAT E THEMELIMIT TË KKTK-së

## Neni 4
## Statusi i KKTK-së

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është agjenci e pavarur, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Ligjit Nr.02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore dhe funksionon sipas Ligjit Nr. 06/L 113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe legjislacionit të ndërlidhur.

## Neni 5
## Selia, simboli dhe vula e KKTK-së

1. Selia e KKTK-së është në Prishtinë;
2. KKTK ka simbolin dhe vulën e vet.

## Neni 6
## Funksionet e KKTK-së

1. KKTK në mënyrë të pavarur dhe profesionale, në përputhje me normat ligjore, konventat ndërkombëtare dhe praktikat bashkëkohore për trashëgimi kulturore, ushtron funksionet e deleguara si në vijim:

1.1. Shqyrton, rishikon, miraton apo refuzon propozimet e pranuara nga Ministria përgjegjëse për trashëgimi kulturore, për përcaktimin e aseteve dhe elementeve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme;

1.2. Identifikon masat e domosdoshme të mbështetjes financiare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse;

1.3. Bashkëpunon me Këshillin Zbatues dhe Monitorues për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;

1.4. Rivlerëson apo rishikon Qendrën e Mbrojtur Historike të Prizrenit me të gjitha elementet e saj, në bashkëpunim me institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore, me kërkesën apo propozimet e parashtruara nga persona fizikë dhe juridikë;

1.5. I propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës ndërmarrjen e masave të nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

1.6. Identifikon dhe i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës prioritete vjetore për mbështetje financiare të trashëgimisë kulturore;

1.7. Bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për trashëgimi kulturore, institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si UNESCO, Këshilli i Evropës etj., për çështje të mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në Republikën e Kosovës;

1.8. Siguron mjete financiare, teknike apo donacione për çështje që lidhen me misionin e tij në fushën e trashëgimisë kulturore;

1.9. Vlerëson projektet e trashëgimisë kulturore të propozuara dhe parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;

1.10. Vlerëson masat mbrojtëse të trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit qendror para miratimit të tyre;

1.11. Ofron mendim profesional mbi ankesat e pranuara nga Ministria përkatëse për Qendrën e Mbrojtur Historike të Prizrenit.

1.12. Vlerësimin dhe përcaktimin e kompensimit për:

1.12.1. rastet e shit-blerjes, trashëgimit ose dhurimit të trashëgimisë kulturore brenda territorit të Republikës së Kosovës.

1.12.2. ndonjë humbje financiare për asetet në mbrojtje të përkohshme;

1.12.3. transferimin e të drejtës pronësore nën kontrollin dhe pushtetin e institucionit kompetent për asetet në rrezik nga dëmtimi i qëllimshëm, shkatërrimi ose mungesa e veprimeve të pamjaftueshme nga pronari, poseduesi ose shfrytëzuesi për të mbrojtur kushtet dhe gjendjen e asetit të trashëgimisë kulturore në pronësi të tij/saj;

1.12.4. gjetjet të luajtshme me interes për arkeologjinë e Kosovës pas aprovimit nga institucioni kompetent;

1.12.5. humbjen e tokës punuese bujqësore ose pronës tjetër ku janë bërë zbulimet të luajtshme dhe ato ruhen në vend (*in situ*).

1.12.6. dëmtimin, shkatërrimin, vjedhjen ose humbjen e objekteve të trashëgimisë së luajtshme nën pronësi private gjatë kohës së ekspozimit.

## Neni 7
## Financimi

1. KKTK financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. KKTK ka kodin e vet buxhetor që e administron në mënyrë të pavarur në përputhje me legjislacionin për buxhet dhe financa.

3. KKTK mund të aplikojë dhe të pranojë donacione nga donatorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4. Pagat e anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial dhe nëpunësve civilë të Sekretariatit të KKTK-së rregullohen sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

5. Buxheti i KKTK-së aprovohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe përfshihet në Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

## Neni 8
## Mbikëqyrja dhe Performanca e KKTK-së

1. KKTK mbikëqyret në mënyrë të përhershme nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht nga komisionet përkatëse.

2. KKTK harton dhe i propozon komisionit përkatës të Kuvendit, Planin Vjetor të Performancës për vitin e ardhshëm në përputhje me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

3. Plani Vjetor i Performancës miratohet në bazë të një procesi dialogu nga Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. KKTK i paraqet komisionit përgjegjës për trashëgimi kulturore Raportin Vjetor të Performancës në përputhje me Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura. Raporti i performancës përmban informacione të detajuara për arritjen e objektivave, aktiviteteve dhe rezultateve të përcaktuara në Planin Vjetor të Performancës.

5. KKTK mund të hartojë raporte për periudha më afatshkurtra apo raporte për çështje të posaçme, nëse kërkohet nga Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. KKTK i raporton Komisionit Parlamentar për mbikëqyrjen e financave publike të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me Raportin Financiar dhe Raportin e Auditimit institucional.

7. Plani i Performancës, Raporti Vjetor i Performancës, Raporti Financiar dhe raporti i vlerësimit të performancës miratohen nga Kuvendi dhe bëhen publike përmes mjeteve te përshtatshme.

**Neni 9**

**Transparenca institucionale**

1. KKTK deri më datën 31 mars prezanton Raportin Vjetor të Performancës të vitit paraprak në dëgjim publik.

2. KKTK publikon në uebfaqen zyrtare, Planin e Performancës, Raportin Vjetor të Performancës, Raportin e Vlerësimit të Performancës dhe Rezolutën e Kuvendit.

**Neni 10**

**Bashkëpunimi dhe shkëmbimi reciprok i informacionit**

1. Çdo institucion, organ apo autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të KKTK-së gjatë ushtrimit të kompetencave të tij ligjore.

2. Në ushtrimin e autorizimeve të tyre ligjore, institucionet e administratës shtetërore dhe KKTK-së janë të obliguara të shkëmbejnë informacionin e nevojshëm në kuadër të veprimtarisë së tyre.

**Neni 11**

**ORGANIZIMI I BRENDSHËM I KKTK-së**

1. Organizimi i brendshëm i KKTK-së është sipas strukturës funksionale dhe i bazuar në Rregulloren Nr 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KKTK.

## KREU 3

## ORGANI DREJTUES KOLEGJIAL I KKTK-së

### Neni 12

### Kushtet dhe procedura për emërimin e anëtarëve të ODK-së

1. Organi Drejtues Kolegjial përbëhet nga shtatë (7) anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 4 paragrafi 8 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, të cilët përzgjidhen nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për trashëgimi kulturore dhe emërohen nga Kuvendi Kosovës.

2. Kushtet, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të KKTK-së, përcaktohet nga Komisioni përgjegjës për trashëgimi kulturore.

3. Mandati i anëtarëve të ODK-së përcaktohet sipas legjislacionit ne fuqi.

4. Anëtarët e ODK-së kanë mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

5. Kryetari i Organit Drejtues Kolegjial njofton Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Komisionin përgjegjës, tre muaj para përfundimit të mandatit të anëtarëve aktual me qëllim që të filloje procedurën për propozimin e përzgjedhjes së përbërjes së re të ODK-së.

6. Procedura për emërimin e anëtarëve të rinj të Organit Drejtues Kolegjial të KKTK-së fillon të paktën dy (2) muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të anëtarëve aktual.

### Neni 13

### Kushtet dhe procedura për emërimin e Kryetarit të KKTK-së

1. Secili nga shtatë (7) anëtarët e Organit Drejtues Kolegjial mund të propozohet për Kryetar të KKTK-së. Kryetar zgjedhet njëri nga të paktën dy (2) anëtarë të propozuar të Organit Drejtues Kolegjial të KKTK-së, të cilët kandidojnë për këtë pozitë. Kryetari përzgjedhet me shumicën e thjeshtë të votave përmes votimit të fshehtë gjatë mbledhjes së parë konstituive të Organit Drejtues Kolegjial të KKTK-së.

2. Mandati i Kryetarit fillon nga data e zgjedhjes deri në përfundim të mandatit të Organit Drejtues Kolegjial.

3. Kryetari mund të jap dorëheqje nga posti. Kryetari i dorëzon dorëheqjen Organit Drejtues Kolegjial dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Organi Drejtues Kolegjial zgjedh Kryetarin e ri shtatë (7) ditë pas pranimit të dorëheqjes sipas procedurës së njëjtë.

## Neni 14

## Humbja e statusit të anëtarit të Organit Drejtues Kolegjial

1. Anëtarit të Organit Drejtues Kolegjial i pushon mandati para skadimit të mandatit të tij/saj në rast të:

1.1. Dorëheqjes;

1.2. Vdekjes;

1.3. Humbjes së përhershme të aftësisë së veprimit të konstatuar nga Komisioni mjekësor specialistik;

1.4. Shkarkimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Propozimi për shkarkim mund të iniciohet nga ana e shumicës anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial përmes një (1) dokumenti që përshkruan bazën për shkarkim dhe i dorëzohet Kryetarit të Organit Drejtues Kolegjial.

3.1. Kryetari i Organit Drejtues Kolegjial e njofton Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për arsyeshmërinë e nismës për shkarkim të anëtarit të ODK-së.

3.2. Në rast shkarkimi të anëtarit të ODK-së, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës i dorëzohet kërkesa për inicimin e procedurës së plotësimit të vendit vakant me anëtar të ri.

## Neni 15

## Detyrat dhe përgjegjësitë e Organit Drejtues Kolegjial

1. Zgjedhja e Kryetarit

2. Përcakton trashëgiminë kulturore në mbrojtje të përhershme

3. Miraton propozim-buxhetin e KKTK-së sipas KASH-it dhe qarkoreve buxhetore të MF.

4. Miraton Planin e Performancës së KKTK-së

5. Miraton të gjitha vendimet që janë kompetencë e ODK të KKTK-së

6. Themelon komisione të pavarura për trashëgiminë kulturore sipas autorizimeve të Ligjit për Trashëgimi Kulturor;

7. Miraton Raportin Vjetor të Performancës së KKTK-së.

8. Miraton akte nënligjore dhe shkresa të tjera.

9. Formon grupe punuese për kryerjen e detyrave të caktuara.

10. Zgjedh dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi.

## Neni 16
## Funksionet e Kryetarit

1. Kryetari kryeson ODK-në gjatë mandatit.

2. Kryetari është përgjegjës për koordinimin e politikave të veprimit, strategjive të zhvillimit, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret në kuadër të fushës së përgjegjësive dhe mandatit të KKTK-së.

3. Kryetari siguron që KKTK ofron shërbime të besueshme, transparente dhe të përgjegjshme pa diskriminim mbi baza etnike apo të prejardhjes sociale, gjinore, paaftësisë fizike, religjionit, mendimit politik a ndonjë mendimi tjetër;

4. Kryetari është përgjegjës për:

4.1. Përgatitjen e Raportit Vjetor të Performancës në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm;

4.2. Prezantimin e Planit Vjetor të Performancës anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial para miratimit të tij;

4.3. Dorëzimin dhe prezantimin e Planit Vjetor të Performancës Komisionit të Kuvendit përkatës për trashëgimi kulturore;

4.5. Dorëzimin dhe prezantimin e Raportit Vjetor të Performancës në Komisionin e Kuvendit përkatës për trashëgimi kulturore;

4.6. Kryesimin e takimeve të ODK-së dhe propozimin e rendit të ditës për takimet e rregullta që zhvillohen së paku dy (2) herë në muaj;

4.7. Informimin e Organit Drejtues Kolegjial për të gjitha çështjet;

4.8. Përfaqësimin e KKTK-së para institucioneve vendore e ndërkombëtare;

4.9. Përcaktimin e anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial për të përfaqësuar KKTK-në;

4.10. Angazhimin në punë të tjera në përputhje me Rregulloren e Punës së KKTK-së dhe procedurat përkatëse në lidhje me zbatimin e Programit të Zhvillimit dhe Planit të Veprimit.

5. Në rast të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve të tij në ODK apo veprimeve të parapara brenda një periudhe të caktuar kohore, Kryetari përcakton njërin nga anëtarët për të mbuluar angazhimet e tij dhe njofton anëtarët e ODK-së me shkrim.

## Neni 17
## Përgjegjësitë e anëtarit të emëruar të Organit Drejtues Kolegjial

1. Anëtarët e ODK-së ushtrojnë me ndërgjegje, dinjitet dhe në mënyrë të paanshme funksionin e anëtarit dhe vendosin për kërkesat dhe çështjet tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

2. Secili anëtar merr pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së KKTK, si dhe kryen punët tjera të caktuara me ligj dhe në përputhje me këtë rregullore, në:

2.1. Panelet shqyrtuese lidhur me kërkesat për miratimin ose përcaktimin e aseteve të trashëgimisë kulturore të propozuara për mbrojtje të përhershme, para vlerësimit dhe marrjes së vendimeve përfundimtare nga KKTK;

2.2. Takimet e ODK-së për marrjen e vendimit për rishikim, pranim apo refuzim të asetit të trashëgimisë kulturore të propozuar për mbrojtjen e përhershme;

2.3. Takimet e ODK-së për vlerësimin e projekteve të propozuara dhe kërkesave të parashtruara nga fusha e trashëgimisë kulturore;

2.4. Përpilimin dhe përmbledhjen e raporteve specifike për gjendjen e trashëgimisë kulturore, dhënien e rekomandimeve për masat shtesë në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;

2.5. Diskutime, vendime dhe konkluzione lidhur me çështjet e hartimit të politikave të veprimit, strategjive të zhvillimit, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret në kuadër të fushës së përgjegjësive dhe mandatit të KKTK-së.

2.6. Shqyrtimin dhe votimin për propozimin përfundimtar të planit buxhetor vjetor dhe afatmesëm;

2.7. Mbikëqyrjen, vlerësimin e punës dhe performancës së Drejtorit të Përgjithshëm;

2.8. Çështje dhe aspekte të tjera pune në përputhje me Rregulloret e brendshme të KKTK-së dhe procedurat përkatëse në zbatim të Programit Zhvillimor të KKTK-së dhe Planit të Veprimit.

3. Anëtarët e ODK-së diskutojnë dhe vendosin për çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e përgjithshëm të KKTK-së, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në miratimin e:

3.1. Përzgjedhjes së Kryetarit të Organi Drejtues Kolegjial;

3.2. Përzgjedhjes dhe shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm;

3.3. Planit të Performancës për çdo vit;

3.4. Raportit Vjetor të Performancës për çdo vit;

3.5. Propozimit përfundimtar të Planit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm;

3.6. Vendimeve lidhur me vlerësimin e propozimeve të përgatitura nga panelet shqyrtuese sipas Rregullores Për Vlerësimin dhe Përcaktimin e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përhershme për rishikimin, pranimin apo refuzimin e përcaktimit të aseteve të trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme;

3.7. Prioriteteve të qarta për ndarjen/alokimin e burimeve që i vihen në dispozicion të KKTK-së nga buxheti;

3.8. Ndarjes së përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që i vihen në dispozicion nga buxheti i KKTK-së apo donatorët;

3.9. Sigurimin që shërbimet e besueshme ofrohen në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme duke mos diskriminuar përkatësinë etnike ose shoqërore, racën, gjininë, paaftësinë, religjionin, opinion politik ose të tjera;

3.10. Zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve, procedurave dhe proceseve adekuate në përkrahje të funksionimit dhe funksionalitetit të KKTK-së;

3.11. Politikave për ngritje të kapaciteteve dhe miratimin e programit të aftësimit për personelin e KKTK-së në fushat përkatëse të përgjegjësisë;

3.12. Propozimit përfundimtar të buxhetit të KKTK-së që i paraqitet për shqyrtim nga ana e Sekretariatit;

3.13. Angazhimit të ekspertëve për konsultime dhe ekspertiza profesionale mbi bazën e kontratave për shërbime të veçanta;

3.14. Rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e KKTK-së;

**Neni 18**

**Mbledhjet e Organit Drejtues Kolegjial**

1. Organi Drejtues Kolegjial i KKTK-së mban mbledhje të rregullta të punës së paku dy (2) herë në muaj.

2. Anëtarët e Organit Drejtues Kolegjial të KKTK-së janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje, përveç në rastet e arsyetuara me shkrim paraprakisht.

3. Mbledhjet i thërret dhe drejton Kryetari i Organit Drejtues Kolegjial dhe në mungesë të Kryetarit mbledhjet drejtohen nga njëri nga anëtarët që përcaktohet nga Kryetari.

4. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari apo anëtaret e Organit Drejtues Kolegjial.

5. Rendi i ditës miratohet me votat e shumicës së anëtarëve prezent në mbledhje.

6. Kuorumi arrihet me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial të pranishëm në mbledhje.

7. Për të gjitha vendimet nevojitet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial.

8. Vota e secilit anëtar është e barabartë dhe mund të jetë "pro", "kundër" dhe "abstenim".

9. Në rast kur votat janë të barabarta, atëherë votimi mund të përsëritet në atë mbledhje ose të shtyhet për një mbledhje tjetër të Organit Drejtues Kolegjial. Në rast se nuk arrihet vendimarrja pas përsëritjes së votimit të dytë, atëherë vota e Kryetarit e përcakton rezultatin.

10. Votimi në mbledhjet e Organit Drejtues Kolegjial është i hapur, përveç se në raste kur Organi Drejtues Kolegjial vendos për votim të fshehtë.

11. Kryetari i Organit Drejtues Kolegjial mund të thërras edhe mbledhje të jashtëzakonshme.

12. Mbledhja e jashtëzakonshme mund të thirret edhe me propozimin e nënshkruar të së paku katër (4) anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial.

13. Mbledhjet e Organit Drejtues Kolegjial në aspektin teknik dhe administrativ organizohen nga Sekretariati i KKTK-së;

14. Me propozim të anëtarëve të Organit Drejtues Kolegjial, nëpunësit e Sekretariatit mund të marrin pjesë në mbledhje.

15. Në mbledhjet e Organit Drejtues Kolegjial mbahet procesverbali dhe përgatitja, ruajtja dhe mbajtja e tij është përgjegjësi e Sekretariatit.

16. Në procesverbal mbahet shënim i saktë i diskutimeve përgjatë mbledhjes se Organit Drejtues Kolegjial ku përfshihen:

16.1. Data, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes;

16.2. Emrat e pjesëmarrësve dhe cilësinë e tyre në mbledhje;

16.3. Rendi i ditës;

16.4. Përmbajtja e diskutimeve;

16.5. Procedurën e votimit, nëse ka mendime të veçanta të përfshihen arsyetimet;

16.6. Vendimi i Organit Drejtues Kolegjial.

17. Në procesverbalet e mbledhjes të Organit Drejtues Kolegjial shënohen në mënyrë të qartë vendimet, personi, departamenti ose divizioni përgjegjës për zbatimin e vendimit dhe afati i përcaktuar kohore nëse nevojitet.

18. Për qëllim të përgatitjes të procesverbalit mbledhjes diskutimet gjatë takimeve të Organit Drejtues Kolegjial mund të incizohet, përmes miratimit nga shumica e anëtarëve të pranishëm të Organit Drejtues Kolegjial.

19. Procesverbali së bashku me ekstraktin aprovohet nga Organi Drejtues Kolegjial në mbledhjen e ardhshme të tij dhe nënshkruhet nga Kryetari.

20. Gjuhët që përdoren në punën e KKTK-së janë gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës;

21. Sekretariati siguron përkthim në gjuhët e zyrtare në mënyrë simultane ose konsekutive për të gjitha mbledhjet e KKTK-së sipas nevojës.

## KREU 4

## SEKRETARIATI I KKTK-së

### Neni 19

### Përbërja e Sekretariatit

1. Sekretariati organizohet sipas Rregullores Nr 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

2. Sekretariati për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive ligjore të tij, posedon personelin ekzekutiv për ofrimin e shërbimeve administrative dhe profesionale.

3. Sekretariati zhvillon dhe propozon rregullat administrative që janë të nevojshme për zbatimin e vendimeve dhe detyrave të KKTK-së. Të gjitha rregullat e tilla i dërgohen ODK-së për miratim.

4. Sekretariati i propozon ODK të KKTK-së politika të reja, rregulla dhe rregullore kurdoherë që është e nevojshme për mbrojtjen efikase dhe efektive të trashëgimisë kulturore.

5. Sekretariati raporton para ODK-së mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe ofron rekomandime.

6. Sekretariati përgatitë propozimin për buxhetin vjetor dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, të cilin e paraqet për miratim nga ODK e KKTK-së dhe administron buxhetin e miratuar.

7. Përshkrimi i plotë i funksioneve të Sekretariatit përcaktohen me Rregulloren për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

8. Sekretariati i KKTK-së ka personelin e nevojshëm për përmbushjen e funksioneve të tij në mënyrë efektive, brenda mundësive buxhetore të tij.

9. Personeli i Sekretariatit janë nëpunës civilë, rekrutimi i të cilëve është i bazuar në kualifikimet profesionale, aftësi dhe meritë, përmes konkursit në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

10. Drejtori i Përgjithshëm mund të angazhojë ekspertë dhe profesionistë tjerë për të ushtruar shërbime dhe ofruar asistencë teknike të caktuar për KKTK-së me miratimin paraprak të ODK-së, sipas nevojës së paraqitur dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara.

11. Shtesat dhe kompensimet e personelit të Sekretariatit të KKTK-së përcaktohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

12. Avancimet, gradimet e stafit dhe lëvizja e personelit bëhen në përputhje me nevojat institucionale, kriteret dhe kushtet e përcaktuara me legjislacionin përkatës.

13. Sekretariati drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili i përgjigjet ODK-së.

**Neni 20**
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja 01/2024 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

**Neni 21**
**Zbatimi**

Organi Drejtues Kolegjial dhe Sekretariati i KKTK-së sigurojnë që e gjithë veprimtaria e KKTK-së zhvillohet në pajtim të plotë me këtë Rregullore dhe legjislacionin përkatës.

**Neni 22**
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Artan Krasniqi

Kryetar i ODK - KKTK-së